



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria Komunale e Arsimit
Odelenje za Obrazovanje
Department of Education

Drejtoria e Arsimit
04nr.203 datë:22.04.2022

Në bazë të nenit 67,68 Ligjit nr.06/L-114, për Zyrtarët Publik, nenit 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 8 pika 6 të UA nr.05/2021-Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik dhe njoftimin e MASHT-it të datës 13.01.2022, sipas referencës nr 018/004 për punësimin e asistent/e për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta, Drejtoria Komunale e Arsimit rishpall:

KONKURS

Pozita: Dy (2) Asistent/e për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e Komunës së Rahovecit

Paga mujore: 397.00 Euro

Përgatitja shkollore: Shkolla e mesme dhe niveli i 5-të (post sekondar) i kualifikimit, asistent/e për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Kohëzgjatja e kontratës: nga dita e emërimit deri më **31.12.2022**.

Punët dhe detyrat për asistent/e për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore:

- ✓ Ndhmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë;
- ✓ Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- ✓ Përgatit material mësimorë si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës.
- ✓ Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuara të fëmijëve, përgatitin format kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve;
- ✓ Promovon arsimin gjithë përfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, për pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës;
- ✓ Mbikëqyr dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre;
- ✓ Planifikon me mësuesin/mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitete dhe ngjarje me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim;

- ✓ Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështet dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin;
- ✓ Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;
- ✓ Prezenton punën dhe arritjet e nxënësve. Informacionet në shkollë i trajton si plotësisht konfidenciale;

Dokumentacioni i nevojshem për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Diplomat ose Certifikatën e diplomës së kualifikimit të nivelit të pestë (5-të) PEARSON kopje e vërtetuar,
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Certifikata që nuk jeni nën hetime

Data e njoftimit në web-faqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej datës. 22.04.2022 deri më datën 23.05.2022.

Konkursi është i hapur 8 (tetë) ditë nga data 24.05.2022, deri më datën 31.05.2022.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Drejtorinë Komunale të Arsimit.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Të gjitha dokumentet të dorëzohen në kopje (dokumentacioni nuk kthehet).

Rezultatet shpallen në linkun: <https://kk.rks-gov.net/Rahovec> dhe <https://konkursi.rks-gov.net/>.

DREJTORI I DKA-së:

Anni Morina

